



“EMF Creative” SH.P.K.
Nr. i biznesit 71107337
Pronar - Milot LLALLOSHI
OSHMA KUTIA.tv
Rr/ Nazim Gafurri Nr.56,
Prishtinë

Ref: 1805/601/LIC/ni

VENDIM

për ndryshim të emrit të OSHMA KUTIA.tv në “Premier Songs”

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. KUTIA.tv është Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizual, i licencuar për transmetim të programit përmes operatorëve të shpërndarjes, me seli në Prishtinë. Vendimi për licencimin e OSHMA KUTIA.tv është lëshuar nga ana e KPM-së, më datën 27 nëntor 2014.
3. Më datën 22 mars 2018, OSHMA KUTIA.tv ka parashtruar një kërkesë me shkrim, duke kërkuar miratimin e KPM-së për ndryshimin e emrit në “Premier Songs”.

Arsyetimi

4. Komisioni konsideron se, arsyeja e parashtrimit të kërkesës për ndryshimin e emrit të OSHMA KUTIA.tv, është përshtatshmëria e emrit të kanalit me veprimtarinë muzikore të pronarit.
5. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, KPM – 2017/02, respektivisht Neni 21, paragrafi 7, thekson: *“I Licencuari duhet ta identifikojë përmbajtjen e tij me anë të logos, e cila mund të ndryshohet vetëm me miratim paraprak nga KPM-ja.”*

6. Komisioni konstaton se, emri i propozuar për ndryshim “Premier Songs”, nuk është i ngjajshëm me asnjë nga emrat e të licencuarve të KPM-së dhe si i tillë, gjatë përdorimit të tij për identifikim, nuk do të shkaktojë konfuzion tek shikuesit, prandaj, kërkesa për ndryshim të emrit nga KUTIA.tv në “Premier Songs” i plotëson kriteret për miratim.
7. Komisioni konsideron se kërkesa e OSHMA KUTIA.tv për ndryshim të emrit është parashtruar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kushtet për miratim.

Vendim

8. Komisioni marr VENDIM për miratimin e kërkesës për ndryshimin e emrit të OSHMA KUTIA.tv në PREMIER SONGS.
9. Ky VENDIM hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Mujë FERATI
Kryetar
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



09.07.2018
datë